




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. _____
Dep. _____
Dep. _____
Nr. i faq _____
Broj stranica _____
Nr. pages _____

Nr. Prot. _____
Br. Prot. _____
Prot. No. 03-02/3030/1
Data _____
Datum 03.10.2017
Date _____

PRISHTINE



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 02.10.2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2400/17 për z.Naim Fanaj–Drejtor i Qendrës së Shëndetit Mendor dhe Shtëpisë për Integrim në Prizren, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që dëshmojnë për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur, me nr.protokoli AKK-03-02-2400/17 për Zyrtarin e lartë, z.Naim Fanaj, ka qenë një situatë e dyshuar me konflikt interesi për shkak se gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik zyrtarët e lartë nuk kanë të drejtë të ushtrojnë funksion menaxhues në ndërmarrje private.

Agjencia kundër Korrupsionit e ka hap si rast të dyshuar, në lidhje me biznesin privat Ordinanca psikiatrike “Psikiatri”, por gjatë procesit të hetimit është konstatuar se z.Fanaj tashmë e ka shuar në mënyrë vullnetare këtë biznes (DPK-03-02-2858-17). Prandaj, në lidhje me këtë nuk ka situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Shaip Havolli /

